

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**, gjyqtari Besim Susuri, me procesmbajtësen Firdes Santuri, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Çemailj Kurtishi, nga fshati Lubinje e Poshtme Komuna e Prizrenit, për shkak të kundërvajtjes nga neni 15 par.3 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 lidhur me par.1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, në bazë të nenit 31,73 dhe 198 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me datë 23 dhjetor viti 2013 marr këtë:

### AKTVENDIM

Konform nenit 198 par.1 nënpar.8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, **PEZULLOHET**, procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit **Çemailj Kurtishi**, nga i ati Ramo, i lindur më 14.06.1960 në fshatin Lubinje e Poshtme Komuna e Prizrenit, për shkak të kundërvajtjes nga neni 15 par.3 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 lidhur me par.1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, **në mungesë të provuarit**, nga se nuk është provuar se i përmenduri ta ketë kryer kundërvajtjen për të cilën është paraqitë, apo edhe të ndonjë kundërvajtjeje tjetër.

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse bien në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate

### Arsyetim

Duke vepruar sipas kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të Agjencisë Kundër Korrupsion në Prishtinë, me nr. 01-1911/12 të datës 24.05.2012, është zhvilluar procedurë kundërvajtëse kundër të pandehurit Çemailj Kurtishi, Zv. Kryesues i Kuvendit komunal në Prizren, për shkak të kundërvajtjes nga neni 15 par.3 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 lidhur me par.1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050.

Gjendja faktike e përshkruar më për së afërmi si në dispozitiv të aktvendimit është vërtetuar në bazë të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të Agjencisë Kundër Korrupsion në Prishtinë, me nr. 01-1911/12 të datës 24.05.2012, nga mbrojtja e të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, Samir Hoxha zyrtar kontaktues për Kuvendin Komunal të Prizrenit, Ibrahim Krasniqi, shef i shërbimit profesional të KK Prizren dhe dëshmisë së Enis Sadikut, zyrtar i Agjencionit Kundër Korrupsion dhe me administrimin e provave tjera nga shkresat e lëndës.

I pandehuri **Çemailj Kurtishi**, në mbrojtjen e vetë të dhënë në këtë gjykatë, mohoj në tërësi kryerjen e kundërvajtjes për të cilën ngarkohem sipas kërkesës së Agjencionit Kundër Korrupsion në Prishtinë, konsideron se obligimin të cilin e ka pas si Zyrtar Publik në tërësi e ka përmbush, kjo mund të vërtetohet nga formulari për deklarimin e pasurisë të cilin ia prezantoi gjykatës, nga e cila vërtetohet se me datë 29.02.2012 e ka përmbush këtë obligim dhe se gjithmonë pas plotësimit të formularit për deklarimin e pasurisë të njëjtin ia kishte dorëzuar Ibrahim Krasniqi, zyrtar në KK Prizren.

Nga deklarata e dëshmitarit **Samir Hoxha**, Zyrtar Kontaktues në KK Prizren, se për vitin 2012 ka qenë zyrtar Kontaktues me AKK-në, ndërsa tani nuk është, deklaron se Agjencioni Kundër Korrupsion, i ka njoftuar ata që ti njoftojnë të gjithë Kuvendarët përkitazi me afatin ligjor për deklarimin e pasurisë-deklarimin vjetor, të njëjtin gjë ia ka përcjellë shefit të shërbimit profesional për punë të Kuvendit **Z. Ibrahim Krasniqi**, i cili ka pas për

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot Br Prot Prot No.
<u>DPK/DMP</u>	<u>03-93/14</u>
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
<u>02</u>	<u>10.01.2014</u>
PRISHTINE	

03-93/14/02  
Kuj

obligim që ta njoftoi çdo njërin zyrtar për obligimin Ligjor për deklarimin e pasurisë, që do të thotë se këtë e ka bërë me kohë dhe në afatin e duhur.

Nga dëshmia e **Ibrahim Krasniqit**, shef i shërbimit profesional të KK në Prizren, vërtetohet se: i përmenduri si më lartë Çemailj Kurtishi, e ka plotësuar formularin për deklarimin e pasurisë, me të cilin ka disponuar ky shërbim, duke qenë jo i informuar shërbimi nga pika kontaktuese- zyrtari i cili ka qenë i obliguar nga Agjencioni Kundër Korrupsion ta bëjë njoftimin përkatës, shërbimi nuk ka pas dijeni për procedurat e mëtejme, andaj edhe deklarata- formulari i formës së vjetër nuk ka qenë adekuat, i emëruari ka qenë i njoftuar nga ana e shërbimit që duhet ta bëjë plotësimin e formularit përkatës për deklarimn e pasurisë për vitin 2012, të cilit njoftim i emëruari i është përgjigjë dhe e ka bërë plotësimin e formularit përkatës i cili i është dorëzuar Agjencionit Kundër Korrupsion, i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AKK-së.

Gjykatës si provë i jepet Lista e Anëtarëve të Kuvendit të cilët i kanë dorëzuar deklaratat për vitin 2012, nga ku shihet se me numrin rendor nën 3, Qemailj Kurtishi, ka bërë dorëzimin e deklaratës me datë 28.03.2012, saktësin e kësaj liste e ka vërtetuar Shefi i shërbimit Profesional për punë të Kuvendit Ibrahim Krasniqi.

Përfaqësuesi i Agjencionit Kundër Korrupsion zyrtari **Enis Sadiku**, deklaroi se kërkesën për deklarimin e pasurisë nga Qemailj Kurtishi e kishin bërë përmes personit Kontaktues të KK të Prizrenit, i cili është i obliguar ti njoftoi zyrtarët e lartë për obligimin Ligjor të tyre për deklarim të pasurisë, në rastin konkret është kërkuar deklarimi i pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë për vitin 2012.

Nga njoftimi i Agjencionit Kundër Korrupsion i datës 15.10.201, nga i pandehuri është kërkuar të bëjë plotësimin e të dhënave personale-nuk e ka plotësuar rubrikën ku kërkohet numri personal.

Nga e prezantuar sa sipër, ndaj të pandehurit Çemailj Kurtishi, nga fshati Lubinje e Poshtme Komuna e Prizrenit, për shkak të kundërvajtjes nga neni 15 par.3 të ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 lidhur me par.1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë nr. 04/L-050, u deshtë të pezullohet procedura kundërvajtëse konform nenit 198 par.1 nënpar.8 te Ligjit mbi kundërvajtjet, nga se në asnjë mënyrë nuk është provuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen që i vihet në barë.

Shpenzimet e krijuara procedurale, bien në barrë të mjeteve bugetore të kësaj gjykate.

Me sa u cek sa më sipër, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

#### **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**

**Nr.496/12-05**

**Datë: 23 dhjetor viti 2013**

**Procesmbajtëse**

**Gjyqtari**

**Firdes Santuri**

**Besim Susuri**

**UDHËZIM JURIDIK:** Pala e pa kënaqur, kundër këtij aktvendimi, ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë-Divizionit të Kundërvajtjes, përmes kësaj gjykate.